



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.230/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Afijete Sada - Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik LISTA SERBE, dega në Leposaviq, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.230/2017 e paraqitur me datë 17.10.2017, me të cilën kërkohet që subjektit politik Lista Serbe, ti shqiptohet dënimi me gjobë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët.

A r s y e t i m

Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS) me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP me datë 17.10.2017, me të cilën pretendon se subjekti politik Lista Serbe gjatë një tubimi zgjedhor në Komunën e Leposaviqit me kandidatin për Kryetar të Komunës Zoran Tadiq dhe me liderin e partisë Slavko Simiq, ka përfshirë persona nën moshën 18 vjeçare në fushatë. Parashtruesi i ankesës ka shtuar se nga fotografit e ofruara si provë të cilat janë marrë nga profili zyrtar i Slavko Simiq në facebook, shihet qartë se bëhet fjalë për një tubim partiak zgjedhorë ku shihen fëmijët të ulur në rendet e para të klasës. Më tej ka theksuar se kjo bile ndesh me Rregullën Zgjedhore 13/2013 neni 5.2. Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se Lista Serbe gjatë një tubimi zgjedhor në Komunën e Leposaviqit me kandidatin për Kryetar të Komunës Zoran Tadiq dhe me liderin e partisë Slavko Simiq, ka përfshirë persona nën moshën 18 vjeçare në fushatë, Paneli i vlerësoi se janë të paqëndrueshme pasi që nga fotografit që gjenden në shkresat e lëndës nuk ka asnjë element të fushatës zgjedhore nga postimi i bërë, pasi që nga foto shihet se fëmijët kanë qenë në shoqërim të prindit dhe po ashtu ata nuk shihet se kanë qenë duke promovuar ndonjë material zgjedhorë të subjektit në fjalë.

Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuara më dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 230/2017 me datë 18.10.2017.



Kryesuesi i Panelit

Adnan Konusheyci

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.